



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M


- I. Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me datë: 30 tetor 2023, 21 dhjetor 2023, 29 dhjetor 2023, dhe 15 janar 2024 nëpërmjet kësaj aprovohen si procesverbale të mbledhjeve të Bordit të cekura më lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave procesverbalet e mbledhjeve paraprake të mbajtura me datë 30 tetor 2023, 21 dhjetor 2023, 29 dhjetor 2023, dhe 15 janar 2024. Dokumentet aprovohen në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-196/2

Në bazë të nenit 15.1 dhe 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 15.3 të Statutit të Bordit të AKP-së, Nenit 17.3.3 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente publike Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e palës Valdrin Kasumaj për qasje në procesverbal të Bordit nga mbledhja e mbajtur me datën 29.12.2023.

II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga pala Valdrin Kasumaj për qasje në procesverbal të Bordit nga mbledhja e mbajtur me datën 29.12.2023.

Bordi e ka parasysh dispozitën ligjore ku thuhet se procesverbalet/diskutimet në Bord, duke përfshirë votimin e Drejtorëve individual, janë konfidenciale dhe mund të bëhen publike vetëm me autorizim të Bordit, të Drejtorit individual në fjalë apo nga ana e autoriteteve kompetente ligjore (Zyrës Kombëtare të Auditimit, organeve të gjyqësisë apo hetuesisë).

Duke konsideruar se procesverbalet e Bordit janë përmbledhje e diskutimeve kryesore, prezencën e pjesëmarrësve, vendimet, votimet për ato vendime dhe diskutimet tjera lidhur me çështjet e Agjencisë. Pjesa kryesore e këtyre procesverbale janë vendimet e Bordit, të cilat pas aprovimit nënshkruhen nga Kryesuesi individualisht sipas formës së duhur me arsyetimin e duhur dhe po ashtu janë të qasshme për publikun në web faqen Agjencisë. Diskutimet tjera që mund të bëhen gjatë mbledhjes së Bordit me Menaxhmentin apo pjesëmarrësit tjerë janë diskutime të brendshme lidhur me çështje të ndryshme organizative dhe menaxheriale, si dhe qëndrime individuale të pjesëmarrësve për këto çështje dhe çështje tjera, të cilat nuk bëhen publike pa autorizim të autoriteteve kompetente ligjore.

Me datën 29 dhjetor 2023 Agjencia Kosovare e Privatizimit ("AKP") me konkretisht Divizioni i Burimeve Njerëzore (DBNJ) ka pranuar e-mailin nga pala Valdrin Kasumaj përmes të cilit është ankuar në vendimin e Bordit për anulimin e konkursit të rekrutimit për dy ZDE Operativë dhe Funksione të Përgjithshme. DBNJ me datë 05 janar 2024 palës i ka kthyer përgjigjja dhe poashtu i janë dhënë/dërguar dy vendime: vendimet me numër ref. BD-194/1 (vendimi emergjent për anulim konkursi) dhe nr. ref. BD-194/2 (vendimi i Bordit për ratifikim të vendimit emergjent). Pala përsëri i është adresuar Agjencisë, respektivisht DBNJ me datë 06 janar 2024 ku ka kërkuar procesverbalin e mbledhjes së Bordit për anulim të konkursit. Me datë 22 janar 2024 zyrtarja për qasje në dokumente zyrtare e ka njoftuar palën me përgjigjen ku është sqaruar se procesvervali i datës 29.12.2023 finalizohet/aprovohet në mbledhjen e datës 30.01.2024.

Sipas Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente publike, respektivisht nenit 17.3.31 parashihet që institucioni mund t'i lejoj palës e palës qasjen në një dokument zyrtar me qëllim të realizimit të një të drejte bazuar nën 17.3.3 të gjithnjë që lidhet me zbatimin e funksioneve publike ose marrëdhëniet e punësimit të zyrtarëve publik, përveç në rastet kur ka të dhëna personale të mbrojtura apo kur saktësohet



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

ndryshe në ligjet përkatëse. Ky nen favorizon kërkesën e palës sepse ndërlihet me konkurrimin e tij në konkursin për ZDE të AKP-së. Për më tepër vendimi për anulim të konkursit për dy ZDE-të ka qenë vendim emergjent i Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesueses dhe aty nuk ka procesverbal sepse nuk ka pas mbledhje, ndërsa me këtë çështje ndërlihet vendimi i mbledhjes 29 dhjetor 2023 ku Bordi sipas procedurave ka ratifikuar vendimin emergjent në fjalë dhe të njëjtin e ka llogaritur si vendim të vetin.

Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196-3

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (LKBFP), përkatësisht nenit 23 (1.4), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet dorëzimi i Raportit Vjetor të Punës së Divizionit për Auditim të Brendshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për periudhën janar-dhjetor të vitit 2023.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Divizioni i Auditimit të Brendshëm për aprovimin e dorëzimit të Raportit Vjetor të Punës së NJAB për periudhën janar-dhjetor të vitit 2023.

Sipas kërkesave që dalin nga Ligji Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (LKBFP), është përgjegjësi e Udhëheqësit të Divizionit të NJAB-së që të përgatitë dhe dërgoj raportin vjetor të Njësia Qendrore Harmonizuese më së largu deri me pesëmbëdhjetë (15) janar të vitit pasues.

Puna është përfunduar sipas planit dhe ka rezultuar me të gjetura dhe rekomandime përkatëse të cilat janë bazuar në kërkesat ligjore, si raporte finale janë prezantuar të Komiteti i Auditimit e më pas edhe tek Bordi i Drejtorëve.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni X
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/4

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palës me numër KB-1778/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 22.01.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH PIK "Kosova Export- OOUR Industria e Mishit me Frigorifer"(PRN008).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 22.01.2024 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH PIK "Kosova Export- OOUR Industria e Mishit me Frigorifer"(PRN008).) Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërbenë si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni X
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/5

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e palës _____ me numër KB-1421/16, ku bartësi i së drejtës banesore është _____ e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar sipas Raportit të Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 22.01.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh Treska-Skopje (MIT147).

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 22.01.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtrues i kërkesës: _____ në cilësinë e të autorizuarit nga ku bartësi i së drejtës banesore është _____ Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e _____ janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se të gjitha dokumentet të paraqitura nga pala janë kopje të pa-noterizuara dhe si të tilla nuk mund të mirën parasysh si dëshmi në këtë procedurë të shqyrtimit. Gjithashtu parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të argumentoj me anë të provave se është bartës i të drejtës banesore. I njëjti nuk posedon Kontratë për shfrytëzimin e banesës me BVI sikurse parashihen në nenin 3 paragrafi 1.6 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta e banesore Nr. 04/L-061, e lidhur me Nenin 37 dhe 38 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83-29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat për kërkesën për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi të refuzohet si e pabazuar.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.


Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/6

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa parashtrues Mone Hodaj, ku bartës i së drejtës banesore është me numër KB-1723/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 22.01.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Kabllar" Mitrovicë.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 22.01.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtruesja e kërkesës: ku bartës i së drejtës banesore është Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon Vendim mbi ndarjen e banesës nga ndërmarrja, dhe Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83-29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi refuzimin e kërkesës si e pabazuar.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/7

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa parashtruar nga parashtruesi me numër KB-1751/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 22.01.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Kabllar" Mitrovicë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 22.01.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtruesi i kërkesës: Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se nuk posedon Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Nga përgjigja e Drejtorisë për planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Sektori i Banimit Komuna Glllogocit, e datës 12.12.2023, Komisioni është informuar se banesa në fjalë nuk ka pranim teknik, andaj edhe nuk kane lidhur kontrate me shfrytëzuesit. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-196/8

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Baneseve mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruar nga parashtruesja me numër KB-1757/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Baneseve të datës 22.01.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "16 Nëntori, NSH 28 Nëntori" Gjilan.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 22.01.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtruesi i kërkesës: Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Baneseve për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Baneseve") lidhur me kërkesën e janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se nuk posedon Vendim mbi ndarjen e Banesës dhe Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Nga kërkesat e palës në institucione relevante për të siguruar dokumente mbi banesën në fjalë, pala ka pranuar përgjigje negative/për pamundësinë e gjetjes së dokumenteve: vendim mbi ndarjen e banesës dhe kontratën e shfrytëzimit të banesës. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/9

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës: me numër KB-1754/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 22.01.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH: "Ramiz Sadiku- OOUR "Remonti dhe Mirëmbajtje" Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 22.01.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtruesi i kërkesës: Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se posedon Vendim të përkohshme mbi ndarjen e Banesës, ndërsa nuk posedon Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86. Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/10

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115 në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Agjencia shpallet jokompetente për kërkesën e parashtruar nga [] me numër KB-1763/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 22 janar 2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga "Komisariati për Refugjat i Republikës Serbisë".
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 22.01.2024 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës [] për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga "Komisariati për Refugjat i Republikës Serbisë" Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka nuk i plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës nga AKP pasi që subjekti juridik "Komisariati për Refugjat i Republikës Serbisë" nuk është NSh dhe nuk bie nën jurisdikcionin administrativ të Agjencisë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/11

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115 në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Agjencia shpallet jokompetente për kërkesën e parashtruar nga ku bartës
i së drejtës banesore është me numër KB-1785/23 e përfshirë në Raportin e
Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 22 janar 2024 për blerjen e banesës të ndarë në ar
shfrytëzim nga "Bashkësia e Shërbimeve Profesionale, Mbrojtjes Sociale dhe e Sigurimit
Pensionalo-Invalidor e Komunës së Prishtinës". te,
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve. te
ti
ti
te


ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 22.01.2024 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës ku bartës i së drejtës banesore është
për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga "Komisariati për Refugjat i Republikës
Serbisë" Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me
ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe
pasi që pala i ka nuk i plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës nga AKP pasi që subjekti juridik
"Bashkësia e Shërbimeve Profesionale, Mbrojtjes Sociale dhe e Sigurimit Pensionalo-Invalidor e Komunës
së Prishtinës" nuk është NSh dhe nuk bie nën jurisdikcionin administrativ të Agjencisë, Bordi vendosi si
në dispozitiv të këtij vendimi. te
ti
ti
te

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mehfor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/12

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve, i datës 11.01.2024 lidhur me statusin juridik të aseteve të lidhur me KPS1541/PRN209, Ndërmarrja Organizatë Bazë e Punës së Bashkuar "Stacioni i Veterinës" Podujevë/Kosovë sipas të cilit të gjitha asetet e kësaj ndërmarrje që janë apo do të identifikohen në të ardhmen nga AKP, janë në pronësi shoqërore dhe të njëjtat bien nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM


Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku sipas tij bazuar në nenin 5.1.1.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L034, si dhe deshmive të dokumentuara në dosjet e lëndëve të lartcekura në të cilat është dëshmuar se Ndërmarrja Organizatë Bazë e Punës së Bashkuar "Stacioni i Veterinës" Podujevë, KPS1541/PRN209, si dhe të gjitha asetet e kësaj ndërmarrje që janë apo do të identifikohen në të ardhmen nga AKP, janë në pronësi shoqërore, andaj rrjedhimisht konform nenit 5 të ligjit të lartcekur të Agjencisë, bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-196-13

Në bazë të neneve 6A dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Vendimi përfundimtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 32/178 të datës 13 dhjetor 2023 për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 1048-3 ZK Bresanë të PRZ007 NSh Sharrprodhimi, Dragash, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i pronës së PRZ007 NSh Sharrprodhimi, Dragash, me detajet e pronës: Prona e paluajtshme nr.1048-3 për realizimin e Projektit "Ndërtimi i Zonës së Gjellbër-Parkut Publik për nevoja të Komunitetit", në emër të Komunës së Dragashit në përputhje me Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Shpronësim nr. 32/178, të datës 13 dhjetor 2023.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovim të propozimit për dhënie të pëlqimit për regjistrim/bartje në librat kadastral të pronës së paluajtshme nr. 1048-3 ZK Bresanë, Dragash të PRZ007 NSh Sharrprodhimi, Dragash për realizimin e Projektit "Ndërtimi i Zonës së Gjellbër-Parkut Publik për nevoja të Komunitetit", në përputhje me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shpronësim me numër 32/178 të datës 13 dhjetor 2023.

Më datë 13.12.2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 32/178 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme të PRZ007 NSh Sharrprodhimi, Dragash, nr.1048-3 ZK Bresanë për ndërtimin e lokacionit për realizimin e Projektit "Ndërtimi i Zonës së Gjellbër-Parkut Publik për nevoja të Komunitetit", në emër të Komunës së Dragashit. Më datë 5 janar 2024 AKP-ja ka dërguar shkresën nëpërmjet së cilës janë paraqitur të dhënat e llogarisë bankare dhe shuma për pagesë. Pas Vendimit Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 32/178 të datës 13.12.2023 si dhe zbatimit të të gjitha procedurave ligjore të këtij shpronësimi, më datë 17 janar 2024 nga Komuna e Dragashit është pranuar dëshmia e pagesës së 20% të shumës totale të shpronësimit 2,916.00€, në emër të shpronësimit për pronën e paluajtshme nr. 1048-3 ZK Bresanë, Dragash të PRZ007NSh Sharrprodhimi, Dragash dhe që titulli pronësor të kalojë në emër të Komunës së Dragashit. Komuna e Dragashit më datë 17 janar 2024 ka dërguar në AKP letër zotimin të nënshkruar nga Kryetari i Komunës me datë 09.01.2024 se do të përmbahet nenit 6A, paragrafi 3 të Ligjit të AKP-së lidhur me shumat tjera të nevojshme për pagesa, para se të merr vendim Bordi i Drejtorëve i AKP-së për lejin e bartjes së pronës.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024.

Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr. 7/2023 për qiradhënie të aseteve të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e Depos në kompleksin e Ndërmarrjes në sipërfaqe prej 300m² dhe në vlerë prej 250.00€ në emër të Medikos Pharma sh.p.k, x dhe Objekti (depo) në kompleksin e NSH Jatex në sipërfaqe prej 220m² dhe në vlerë prej 400.00€ në emër të Medikos Pharma sh.p.k nga Medikos Pharma sh.p.k tek Eximtex sh.p.k., me kushte të njëjta.

- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës së qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Me datë 07 nëntor 2023 qiramarrësi i cili është pronar i Medikos Pharma sh.p.k. dhe Eximtex sh.p.k. ka parashtruar kërkesë që dy kontratat e qirasë që janë të nënshkruara në emër të Medikos Pharma sh.p.k. të kalojnë në emër të biznesit Eximtex sh.p.k. për arsye ekonomike dhe meqenëse pronari i dy bizneseve është i njëjtë. Qiramarrësi Medikos Pharma ka të nënshkruar kontratë të qirasë me Ndërmarrjen Jatex për asetin objektin (depo) në kompleksin e Ndërmarrjes që nga viti 2005, ndërsa për asetin depo në kompleksin e Ndërmarrjes ka kontratë të qirasë me Ndërmarrjen që nga viti 2011. Qiramarrësi Medikos Pharma sh.p.k dhe Eximtes sh.p.k. është pagues i rregullt i qirasë. Sipas pagesave të bëra deri me datë 31 dhjetor 2023 për të 3 asetet janë përmbush detyrimet. Sipas vlerësimit të DKAD , transferimi i Kontratës së Qirasë nga biznesi Medikos Pharma tek biznesi Eximtex sh.p.k. nga do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-196/15

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Nenit 9.5 të Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve dhe Neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për rishikim dhe vazhdim të kontratës së qirasë për tokë bujqësore, ashtu që obligohet Autoritetit të Likuidimit të vazhdojë kontratën e qirasë vetëm për parcelat 22-4 dhe 23-2 ZK Nagllavë në sipërfaqe totale prej 1 ha 11 ari me qira vjetore në lartësinë prej 1,525.00 € me palën Jahë Binakaj.
- II. Në rast se pala nuk pajtohet të vazhdojë kontratën e qirasë me çmimin prej 1,525.00 € atëherë asetet duhet të lirohen dhe të vendosen për qiradhënie përmes tenderit publik.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës për rishikimin dhe vazhdimin e kontratës së qirasë për palën Jahë Binakaj.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se Z. Jahë Binakaj ishte qiramarrës i parcelave nr. 22-4, 22-5, 22-6, 22-7, 22-8 dhe 23-2 në ZK Nagllavë në sipërfaqe të përgjithshme prej 7ha 98ari 69m² (79869 m²) me kontratë të qirasë me nr. protokollit 392/2023 të shkëputur me dt. 08.11.2023 përmes shkresës së pranuar personalisht nga pala dhe në bazë të kësaj kontratë të qirasë lartësia e qirasë vjetore ishte 1,525.00 €. Më datë 07.11.2023 Zyra Rajonale Pejë nga Dhoma Posaçme Gjykatës Supreme, është njoftuar se për disa parcela të cilat janë dhënë me qira është caktuar masa e sigurisë e cila e ndalon ti shes, disponojë, ti japë me qira, me hipotekë apo të ndërmarrë çfarëdo veprimi që kanë për qëllim tjetërsimin e parcelave si në vijim: parcela nr.22-5; 22-6; 22-7; 22-8 ZK Nagllavë. (AC-I-23-0598-A0001). Lidhur me këtë, pasi që ekziston një kontratë vjetore shfrytëzimi për parcelat e lartpërmendura është kontaktuar ish qiramarrësi, i cili njëherësh është edhe pages i rregullt në bazë të kontratës së qirasë z. Jahë Binakaj ku gjatë takimit të dt. 08.11.2023 dhe i është dorëzuar shkresa mbi shkëputjen e kontratës së qirasë për arsyet e lartpërmendura. Rrjedhimisht me 20.12.2023 ZR Pejë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 306/2023-IN nga z. Jahë Binakaj me anë të së cilës kërkon që të rishikohet kontrata e qirasë. Në kërkesën e tij janë paraqitur shpenzimet e përgjithshme për adaptimin dhe mbjelljen e tokës dhe arrijnë shume prej 5,734.00€ Gjithashtu, z. Jahë Binakaj kërkon që ti mundësohet shfrytëzimi i parcelave nr.22-4 ne sipërfaqe prej 10305m² dhe 23-2 ne sipërfaqe prej 859m² ZK Nagllavë, këto parcela janë te lira nga vendimi i masës së sigurisë të DHPGJS-së, gjenden afër binarëve të trenit dhe së bashku e kanë një sipërfaqe prej 1ha 11ari 64m².

Sipas vlerësimit të AL-së, vazhdimi i Kontratës së Qirasë vetëm për parcelat 22-4 dhe 23-2 ZK Nagllavë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Për më tepër, duke u bazuar edhe në kërkesën e palës të datës 20.12.2023, kontrata e qirasë në lidhje me këto dy parcela do të vazhdohej sipas kushteve të kontratës paraprake, ashtu siç edhe deklaroi pala që “dëshiron të vazhdojë të shfrytëzojë në bazë të kontratës paraprake” e që nënkuptohet që në këtë rast për qiradhënien e këtyre dy parcelave do të paguhej çmimi 1,525.00 € për vit. Vazhdimi i kontratës së qirasë vetëm për këto dy parcela, arsyetohet edhe mbi faktin që gjatë sezonës së vjeshtës së vitit 2023 pala ka adoptuar tokën dhe e ka mbjellur me grurë dhe kësioj i janë krijuar shpenzime dhe poashtu planet e tij afariste bazohen edhe në planifikimet që ka bërë në mbjelljen e këtyre kulturave në këto parcela.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-196/16

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërliken me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Nenit 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve dhe Neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Dërgohen në rivlerësim të çmimit për qiradhënie asetet e Nsh Borba në Prishtinë PRN206, për lokalin nr.1 për parashtruesin e kërkesës D.P.Z. "Studio Meli&Nifa" dhe për lokalin nr.3. B.I për parashtruesin e kërkesës Florije Vllasaliu.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës për qiradhënie direkte për dy hapësira në asetin e Nsh Borba në Prishtinë, pronë e Nsh Borba – Aseti në Prishtinë, PRN206 (në likuidim).


Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se aset i Nsh Borba në Prishtinë është aset i ri, i cili me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së Nr. Ref.BD-183/26 të datës 23 qershor 2023 ka hyrë nën administrim të AKP-së. Nsh Borba ka hyrë në procedurë të likuidimit më datë 15.11.2023. Pas aprovimit të statusit është bërë identifikimi i asetit të Nsh Borba, i cili gjendet në Kurriz, Dardani, Lamela 10, me sipërfaqe prej 125.75 m2. Lokali është ndare në tri pjesë dhe dy pjesë të lokalit janë duke u shfrytëzuar nga biznese private, ndërsa një pjesë është e lirë. Pas identifikimit të lokalit dhe dërgimit të njoftimit shfrytëzuesve, të njëjtit kanë konfirmuar se i kanë paguar qira personave tjerë sepse nuk kanë qenë në dijeni se ajo pronë ka qenë aset i ndonjë ndërmarrjeje shoqërore dhe kanë shprehur gatishmëri të lidhin kontratë me Agjencinë. Pasi që palët kanë parashtruar kërkesë që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë dhe aktualisht të njëjtit janë shfrytëzues, është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kështu më datë 22 janar 2024 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien e lokalit nr.1 me sipërfaqe prej 59 m2 dhe lokalit nr.3 me sipërfaqe 53 m2 të cilat gjenden në Prishtinë - Kurriz, Dardani, Lamela 10. Më datë 25 shtator 2023 AKP-ja ka pranuar kërkesën nga D.P.Z. "Studio Meli&Nifa" dhe Florije Vllasaliu B.I përmes së cilës palët kanë sqaruar se si e kanë shfrytëzuar lokalin dhe gjithashtu kanë shprehur kërkesë për të lidhur marrëveshje të qirasë me AKP-në.

Bordi ka shqyrtuar raportin e vlerësimit dhe mendon se rivlerësimi i qirasë do të sjellte një shpjegim më gjithëpërfshirës të çmimit dhe çështjes në përgjithësi.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi të rre në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-196/17

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Neni 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për qiradhënie direkte të zyrës nr. 312 pronë e NewCO Grand Hotel në Prishtinë PRN173 për parashtruesin OJQ Këshilli Koordinues i Asociacionit të Familjarëve të Personave të Zhdukur (KKAFZHK), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë prej € 226.00/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës për qiradhënie direkte për zyrën nr. 312 pronë e NewCo Grand Hotel (PRN173) (në likuidim)

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se Autoriteti i Likuidimit kishte pranuar informatat nga Zyra Rajonale Prishtinë se në objektin e Lidhjes së Kooperativave të Kosovës janë të vendosur si shfrytëzues KKAFFZHK, dhe me datë 29.09.2023 ju kishte dërguar shkresë për lirim të asetit ose hyrje në marrëdhënie kontraktuale të qirasë. Pala më datë 10.10.2023 është përgjigjur në shkresën e AL-së, ku kanë shprehur gatishmërinë që të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, mirëpo pa ndonjë kompensim për shkak të kushteve të vështira financiare që kanë si organizatë.

Me datë 21.12.2023 ZR Prishtinë, ka pranuar shkresën të parashtruar nga OJQ KKAFFZHK të cilët kanë adresuar kërkesën qira direkte të zyrës e cila është pronë e NewCo Grand Hotel pasi që KKAFFZHK si organizatë kanë qenë duke e shfrytëzuar përkohësisht me zyre në Objektin e ish-Kooperativat të Kosovës në Prishtinë (LKK) objekt ky i shitur në SHAL64 dhe në bazë të rregullores janë të obliguar ti lirojnë hapësirat. Për këtë arsye DE i AKP-së me datë 18.01.2024, ka lëshuar vendimin për formimin e komisionit për hulumtimin/vlerësimin e çmimit të tregut në lidhje me qiradhënien e zyrës në NewCo Grand Hotel. Sipas matjeve të realizuara rezultoi se zyra nr.312 përfshin sipërfaqe prej 23 m2 dhe është përcaktuar çmimi në shumën prej € 226.00/muaj. Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me palën do të mundëson të inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSH-së. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-196/18

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, nenit 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për qiradhënie direkte të apartamentit nr. 348 pronë e NewCO Grand Hotel në Prishtinë PRN173 të palës Lëvizja për Bashkim, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë prej € 363.00/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës për qiradhënie direkte për apartamentin nr. 348 pronë e NewCo Grand Hotel (PRN173) (në likuidim)

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se Autoriteti i Likuidimit kishte pranuar informatat nga ZR Prishtinë se në objektin e Lidhjes së Kooperativave të Kosovës janë të vendosur si shfrytëzues Lëvizja për Bashkim, më datë 29.09.2023 ju kishte dërguar shkresë për lirim të asetit ose hyrje në marrëdhënie kontraktuale të qirasë. Pala më datë 16.10.2023 është përgjigjur në shkresën e AL-së ku kanë shprehur gatishmërinë që të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë. Me datë 21.12.2023 ZR Prishtinë, ka pranuar shkresën e parashtruar nga Partia Politike "Lëvizja për Bashkim" (LB). LB përmes kësaj shkrese ka adresuar kërkesën për marrje me qira direkte të hapësirës afariste e cila është pronë e NewCo Grand Hotel pasi që Partia Politike LB ka qenë të sistemuar përkohësisht me zyrë në Objektin e ish-Kooperativat të Kosovës në Prishtinë (LKK) objekt ky i shitur në SHAL64 dhe në bazë të rregullores janë të obliguar ti lirojnë hapësirat. Për këtë arsye DE i AKP-së me datë 18.01.2024, ka lëshuar vendimin për formimin e komisionit për hulumtimin/vlerësimin e çmimit të tregut në lidhje me qiradhënien e zyrës në NewCo Grand Hotel. Pas vendimit komisioni vlerësues ka filluar punën dhe së bashku me zyrtarin kadastral të AKP-së me datë 19.01.2024 kanë realizuar vizitë në teren në Grand Hotel ku kanë inspektuar zyrën dhe kanë kryer matjen e tyre. Sipas matjeve të realizuara rezultoi se apartamenti 348 përfshin sipërfaqe prej 36 m² dhe është përcaktuar çmimi në shumën € 363.00/muaj. Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me palën do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSH-së. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialitë paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-196/19

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Ligji Nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Komunës së Rahovecit për lejim të punimeve në ngastrën kadastrale nr. 1817-0 dhe nr. 1318-0 ZK Rahovec, lidhur me projektin "Sheshi Qendror i Qytetit" për të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr vendim preliminar për shpronësim të këtyre ngastrave, të cilat janë në pronësi të NSh Jugopetrol, pasi që ndërtimi i këtij Sheshi është në interes të qytetarëve të Komunës së Rahovecit.
- II. Autorizohet Autoriteti i Likuidimit të bëjë ndërprerjen e kontratës së qirasë me qiramarrësin N.T.P "Veda 3" të vazhduar me aneks kontratën e qirasë me nr. protokoli 46877/2023 të datës 11.05.2023.
- III. Kërkohet nga ana e KK Rahovec që të përmbahet nga fillimi i punimeve deri në skadimin e afatit tridhjetë (30) ditor, nga dita e njoftimit të palës për shkëputjen e kontratës së qirasë, afat ky i përcaktuar në kontratën e qirasë brenda të cilit pala duhet të bëjë lirin e asetit nga momenti i njoftimit për shkëputjen e kontratës së qirasë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për shqyrtimin e kërkesës së Komunës së Rahovecit për lejimin e punimeve në ngastrat kadastrale nr. 1817-0 dhe objektit që ndodhet në parcelën nr. 1318-1 ZK Rahovec si dhe ndërprerja e kontratës së qirasë për pompën e benzinës që ndodhet në këto ngastra.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se Komuna e Rahovecit me datë 27.11.2023 ka dorëzuar një shkresë përmes së cilës ka kërkuar që të i lejohet punimi në ngastrat kadastrale nr. 1817-0 dhe nr. 1318-1 ZK Rahovec, lidhur me projektin "Sheshi Qendror i Qytetit" për të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr vendim preliminar nr. 11/72 të datës 08.11.2023 për shpronësim të parcelës 1817-0 dhe objektit që ndodhet në parcelën 1318-1 ZK Rahovec, të cilat janë në pronësi të NSh Jugopetrol. Poashty me anë të shkresës është kërkuar që të ndërpritet kontrata e qirasë e cila është e nënshkruar në mes të AL të NSh Jugopetrol dhe qiramarrësit N.T.P "Veda 3", ku qiraja mujore është 3,501 € në muaj dhe skadon me datë 30/04/2025.

Në bazë të nenit 2 par.1.5 të Ligjit Nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, respektivisht paragrafi 9 i nenit 11 në Ligjin Nr.03/L-139 fshihet dhe zëvendësohet me si vijon "Personat të cilët janë pronarë ose posedues të pronës në fjalë nuk do të detyrohen që ta lirojnë ose dorëzojnë pronën derisa: 9.1. për ndërtesat të cilat shfrytëzohen në mënyrë aktive për qëllime të banimit ose qëllime afariste, njëzetë (20) ditë kalendarike të kenë kaluar nga data në të cilën kompensimi i përcaktuar në vendimin përfundimtar të jetë paguar në përputhje me nenin 16 të këtij ligji", dhe kështu AKP ka mundësi të mbajë në posedim dhe të administrojë me asetin deri pasi që të lëshohet vendimi përfundimtar për shpronësim dhe të jetë kryer pagesa në lidhje me shpronësimin.

M.H.




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

KK Rahovec kërkesën e tyre e arsyeton mbi faktin që zhvillimi i projektit “Sheshi Qendror i Qytetit” është në interes publik dhe në këtë parcelë do të vazhdohet me implementimin e projektit, ashtu që nëpër parcelën 1817-0 ZK Rahovec është paraparë rruga e cila e lidh rrugën “Ibrahim Rugova” me rrugën “Xhelal Hajda – Toni”. Ndërsa në parcelën 1318-1 ZK Rahovec, e cila është në pronësi të KK Rahovec është paraparë ndërtimi i Tregut të Gjellbër. Në këtë rast kërkesa ka të bëjë me të dy parcelat, ku parcela 1817-0 evidentohet në emër të NSh “Jugopetrol” ndërsa parcela 1318-1 evidentohet në emër të KK Rahovec por mbi të shtrihet një pjesë e pikës së karburantëve e cila është në pronësi të NSh “Jugopetrol” dhe menaxhohet nga AKP. Do të thotë, procedura e shpronësimit prek në tërësi parcelën 1817-0 ZK Rahovec dhe pjesën e objektit të ndërtuar në parcelën 1318-1 ZK Rahovec. Për më tepër, KK Rahovec zotohet që do të paguajë pjesën prej 20% të vlerës së përgjithshme të shpronësimit. Fakt tjetër i rëndësishëm është edhe fakti që objekti i cili është në pronësi të NSh “Jugopetrol” është i ndërtuar në parcelën 1318-1 ZK Rahovec e cila parcelë është në pronësi të KK Rahovec. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024


Mehmed Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-193/20

Në bazë të neneve 6/A par.3, 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M


- I. Aprovohet kërkesa e Autoritetit të Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh IMN Kosova (në likuidim) PRN029 nga Rajoni i Prishtinës.
- II. Autorizohet Autoriteti i Likuidimit që të kërkojë nga institucionet përkatëse, saktësisht KK Prishtinë që të kryejë pagesën në emër të procedurave të shpronësimit bazuar në Vendimin Përfundimtar nr. 07/34 të datës 07 Tetor 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për asetin e NSh IMN Kosova në shumën prej 244,748.00 €, shumë e cila do të mbulojë pagesën e kreditorëve, kërkesat e të cilëve janë aprovuar.
- III. Vihet në dijeni KK Prishtinë, që në procedurën e ankimimit pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës janë në procedurë gjyqësore edhe tridhjetë (30) ankesa të parashtruara nga kreditorët e NSh IMN Kosova, dhe në rast të aprovimit të këtyre ankesave, KK Prishtinë do të duhet potencialisht të paguajë shumën prej 159,689.64 €, aq sa është vlera e këtyre ankesave të parashtruara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
- IV. Autorizohet Autoriteti i Likuidimit që të njoftojë Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) mbi vendimin e Bordit të Drejtorëve për aprovimin e raportit të shpërndarjes së përkohshme për kreditorët e NSh IMN Kosova dhe ky vendim të ju shërbejë si dëshmi që pas pranimit të pagesës sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi, do të kryhet pagesa ndaj Administratës Tatimore të Kosovës si kreditor i NSh IMN Kosova.
- V. Kërkohet nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës që të bëjë lirimin e llogarisë bankare të NSh IMN Kosova nga barra tatimore.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit të NSh IMN Kosova (në likuidim) PRN029 nga Rajoni i Prishtinës. Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJSK, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të NSh IMN Kosova (në likuidim) PRN029 nga Rajoni i Prishtinës. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh. Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-196/21

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobimet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSh PRN082 KB KOSOVA (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 12,000.00 dhe atë për vijët buxhetore si në vijim:
1. e6 (Shpenzimet e reklamave) në vlerën prej 2,000.00 €;
 2. e7 (Shpenzimet e shitjes së aseteve në likuidim) në vlerën prej 1,000.00 €;
 3. e8 (Shpenzimet e vogla administrative, shpenzimet postare) në vlerën prej 1,000.00 €;
 4. e11 (Paratë e imta të Mbyllura , shpenzimet aktuale për shpenzime të vogla të likuidimit) në vlerën prej 1,000.00 €; e14(Shpenzimet e Gjykatës) në vlerën prej 3,000.00 €;
 5. e18 (Ofruesit e shërbimeve(pagesat Neto), në vlerë prej 3,000.00 €;
 6. e20 (Shërbimet profesionale) në vlerën prej 1,000.00 €;
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh PRN082 KB KOSOVA .

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për shpenzimet e reklamave, shpenzimet e shitjes së aseteve në likuidim, Shpenzimet e vogla administrative, shpenzimet postare, paratë e imta të mbyllura , shpenzimet aktuale për shpenzime të vogla të likuidimit, shpenzimet e Gjykatës, Ofruesit e shërbimeve - pagesat Neto dhe shërbimet profesionale - në vlerë prej € 12,000.00 pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSh PRN082 KB KOSOVA. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-196/22

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurën e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSh "Bujqësia" PRN009 (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 30,500.00 dhe atë për vijët buxhetore si në vijim:
 1. e7 (Shpenzimet e shitjes së aseteve në Likuidim) në vlerën prej € 2,000.00
 2. e8 (Shpenzimet e vogla administrative, shpenzimet postare) në vlerën prej € 1,000.00
 3. e14 (Shpenzimet e Gjykatës) në vlerën prej € 1,000.00
 4. e17 (Ofruesit e shërbimeve (Pagesat bruto) në vlerën prej € 1,000.00
 5. e18 (Ofruesit e shërbimeve(pagesat Neto), në vlerë prej € 4,000.00
 6. e19 (Tatimi i të ardhurave personale për Ofruesit e Shërbimeve) në vlerë prej € 1,000.00
 7. e29 (Shërbimet) në vlerë prej € 2,000.00
 8. e35 (Tatimi i paguar për qiranë e pranuar) në vlerën prej € 500.00
 9. e38 (Tatimi i korporatës) në vlerën prej € 18,000.00
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh "Bujqësia" PRN009.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për shpenzimet e shitjes së aseteve në Likuidim, shpenzimet e vogla administrative, shpenzimet postare, shpenzimet e Gjykatës, Ofruesit e shërbimeve (Pagesat bruto), Ofruesit e shërbimeve(pagesat Neto), tatimi i të ardhurave personale për Ofruesit e Shërbimeve, shërbimet, tatimi i paguar për qiranë e pranuar, tatimi i korporatës - në vlerë prej € 30,500.00 pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSh "Bujqësia" PRN009. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/23

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSh "Shpezëtarë & Peshkatari" PRN006 (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 21,550.00 dhe atë për vijën buxhetore si në vijim:
 1. e18 (Ofruesit e shërbimeve (pagesat neto) në vlerën prej € 3,500.00
 2. e19 Tatimi në të ardhura personale për Ofrues të Shërbimeve në vlerë prej € 1,950.00
 3. e22 (Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve) në vlerë prej € 16,100.00
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh "Shpezëtarë & Peshkatari" PRN006.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për Ofruesit e shërbimeve (pagesat neto), e19 Tatimi në të ardhura personale për Ofrues të Shërbimeve, shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve - në vlerë prej € 21,550.00 pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSh "Shpezëtarë & Peshkatari" PRN006. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-196/24

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset nr. P-71914059-02779-6 ZK Prishtinë me sipërfaqe prej 92 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset në pronësi të NSh "Urata" PRN103
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aset i respektivisht nga ngastra kadastrale nr. P-71914059-02779-6 ZK Prishtinë me sipërfaqe prej 92 m² në pronësi të NSh "Urata" PRN103.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se në këtë parcelë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Autoritetit të Likuidimit/AKP-së, për shkak se ngastra kadastrale nr. 02779-6 që është objekt i kësaj kërkesë shfrytëzohet si rrugë publike, saktësisht trotuar brenda lagjes Ulpianë, Zona Kadastrale Prishtinë. Në këtë rast edhe pse trotuar kategorizohet si rrugë publike duke pasur parasysh edhe nenin 6 par.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, në të cilin parashihet që "rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike". Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aset nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjesë të rrugës publike." Për më tepër, heqja dorë nga këto aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-196/25

Në bazë të neneve 6/A par.3, 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit të PRN103 NSH Urata (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtoreve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit të PRN103 NSH Urata (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DHPGJSK, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme plotësuese të fondeve të Likuidimit të PRN103 NSH Urata (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-196/26

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga lokali i rrënuar i NSh "PRVI MAJ" PRN178 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga lokali i rrënuar i NSh "PRVI MAJ" PRN178.


Autoriteti i Likuidimit ka raportuar se lokali i NSh "PRVI MAJ" PRN178 i ndërtuar në parcelën 3995-0 ZK Gjilan (në pronësi të KK Gjilan) është i rrënuar i tëri dhe në bazë të raportit të gjendjes në terren tanimë në këtë parcelë në pronësi të KK Gjilan është i ndërtuar një objekt tjetër privat dhe kështu Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe gjithashtu për shkak të mos ekzistencës tanimë të këtij lokali nuk mund të ushtrohet kontrolli efektiv. Duke qenë në këtë gjendje është e pamundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë tjetër, dhe për këtë arsye është kërkuar që të heqet dorë nga ky aset.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-196/27

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr. 6/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore SHAL 58, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet shitja e Njesisë 32-NSH Zhupa Reqane – Prona në Lubinjë e Epërme 1 me blerës ne cmim 111,111€.
- II. Drejtori Ekzekutiv udhëzohet të nënshkruajë marrëveshjen për shitblerje të aseteve dhe dokumentet tjera përcjellëse. Drejtori dhe menaxhmenti i AKP-së gjithashtu do të ndërmarrin të gjitha veprimet e domosdoshme me qëllim që të përfundojnë transferimin e asetit dhe për përfundim të transaksionit të shitjes.
- III. Dokumentet e tilla të referuara në paragrafin (II) më lartë do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre nga palët e domosdoshme, pa nevojë për ratifikim pasues nga ana e Bordit, kërkesë prej së cilës këtu hiqet dorë sa i përket këtyre transaksioneve specifike të privatizimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

A R S Y E T I M

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e SHAL 58.


Bazuar në nenin 14.1 të Rregullave të Tenderit, pasi që çmimi i pranuar është më i lartë se çmimi orientues, është aprovuar shitja e këtij aseti.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aset i në kompetencat administrative të Agjencisë. Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 janar 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

